



CFRR»

Centre for Financial
Reporting Reform



**REPARIS
FOR SMEs**

The logo for STAREP, featuring three green, slanted rectangular bars of varying lengths to the left of the text "STAREP".

STAREP

FORUMI I CFRR-së
PËR RREGULLATORËT

**PËRDITËSIMI
I RREGULLATORËVE PËR SNRF-TË**

13-14 dhjetor 2021, Online

CFRR 
**Centre for Financial
Reporting Reform**



Qendra për raportimin e Reformave Financiare
(CFRR)

Praktika për Qeverisjen Globale, Banka Botërore

Adresa: Praterstrasse 31, 1020 Vienna, Austria

Web: www.worldbank.org/cfrr

Email: cfrr@worldbank.org

Phone: +43-1-217-0700

FORUMI I CFRR-së PËR RREGULLATORËT

PËRDITËSIMI I RREGULLATORËVE PËR SNRF-TË

13-14 dhjetor 2021, Online

PARATHËNIE

Ky seminar virtual synon të përditësojë rregullatorët e sektorit bankar dhe financiar lidhur me udhëzimet e fundit mbi raportimin financiar dhe udhëzimet rregullatore. Ai do të shqyrtojë gjykimet dhe çmuarjet specifike të cilat janë bërë më të rëndësishme si rrjedhojë e pandemisë së COVID-19, duke vënë theksin në veçanti në ato aspekte të kontabilitetit dhe raportimit që aktualisht janë më me rëndësi për pasqyrat financiare të shoqërive të regjistruara në bursë, sidomos të bankave dhe shoqërive të sigurimeve. Seminari do t'u kushtojë një farë kohe edhe përgatitjeve për rregullimin e zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) 17: Kontratat e Sigurimit.

Pandemia e COVID-19 befas e ndryshoi mënyrën se si jetojmë dhe punojmë. Ajo ka ndikuar negativisht në shumë biznese, por ka përshpejtuar zhvillimin e disa të tjerave. Theksi që u vihet përpjekjeve për të 'ndërtuar përsëri më mirë' do të përshpejtojë ndryshimin për arritjen e një 'normaleje të re'. Cilësia e raportimit financiar dhe drejtimit të shoqërive tregtare është një element i rëndësishëm për bërjen të mundur të funksionimit të vazhdueshëm të ekonomisë globale në kohë stresi dhe për sigurimin e kapitalit të nevojshëm për të optimizuar rritjen edhe sipas mundësive që lejon mjedisi. Informacioni financiar i audituar është mjeti zyrtar përmes të cilit bizneset komunikojnë me ofruesit e tyre të jashtëm të kapitalit (investitorët ekzistues dhe potencialë dhe kreditorët e tyre) dhe mund të japë informacion të audituar si input rregullator. Rrjedhimisht, kjo është një kohë kritike për raportimin financiar.

Qeveritë kanë përdorur një gamë të gjerë mjetesh që kanë në dispozicion në kërkim të zbutjes së efekteve të krizës së COVID-19. Trusnia e kësaj situatë i ka detyruar drejtuesit të japin disa gjykime dhe bërë disa çmuarje të vështira lidhur me zbatimin e SNRF-ve. Bashkërendimi ndërkombëtar midis rregullatorëve, organeve që vendosin standardet dhe organeve të tjera në mbarë globin ka bërë që të reagohet me shpejtësi ndaj situatës aktuale, përfshirë edhe duke bërë ndryshime në SNRF.

Seminari virtual është realizuar në kuadër të dy programeve të rëndësishme të Qendrës së Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR): Forcimi i Auditimit dhe Raportimit në Partneritetin Lindor ([STAREP](#)) dhe Rruga drejt Programit për Evropën e Reformës së Kontabilitetit dhe Forcimit të Institucioneve për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme ([REPARIS for SMEs](#)).

STAREP është një program rajonal për vendet e Partneritetit Lindor (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina) i cili u prezantua në tetor 2013 dhe pritet të vazhdojë deri në 2022 me ndihmën e fondeve të tjera të dhëna nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

REPARIS for SMEs është një program holistik për zhvillimin e kapaciteteve rajonale në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia. Ai synon të përmirësojë qasjen e NMV-ve në kontabilitetin profesional dhe shërbimet e menaxhimit financiar dhe të mbështetë harmonizimin e kuadrove kombëtare të raportimit financiar të shoqërive tregtare me Direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. Programi financohet nga Bashkimi Evropian.

Përveç Bankës Botërore dhe ekspertëve dhe rregullatorëve ndërkombëtarë nga STAREP dhe REPARIS for SMEs, të pranishëm në këtë ngjarje do të jenë edhe përfaqësues nga rregullatori i sektorit bankar dhe financiar të Republikës Kirgize.

DETAJE ADMINISTRATIVE

- Ngjarja do të ketë përkthim simultan në gjuhën shqipe, boshnjake/kroate/serbe dhe ruse.
- **Në takim duhet të merrni pjesë** përmes platformës ZOOM duke klikuar linkun në emailin që ka ftesën, ose duke futur numrin e takimit dhe fjalëkalimin e dhënë në ftesë.
- **Lidhuni 15 minuta përpara ngjarjes** për të testuar lidhjen dhe fusni emrin tuaj të plotë.
- **Kini kujdes që mikrofonin ta mbani të fikur gjatë gjithë kohës**, përveç kur moderatori t'ju ftojë të flisni.

VENDET DHE KOHA

- **13:00** – CET, Vjenë, Lubjanë, Beograd, Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë, Shkup, Tiranë
- **14:00** – Kishinau, Kiev
- **15:00** - Minsk
- **16:00** – Baku, Tibilis, Jerevi
- **18:00** – Bishkek

13:00 Hapja

Fjala e mirëseardhjes dhe prezantimi i shkurtër i temës dhe folësve

Garik Sergeyan | Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Banka Botërore

13:05

Qasja me bazë risku ndaj shqyrtimit dhe përdorimit të informacionit financiar të audituar sipas SNRF-ve

Ky sesion ka qëllim të dyfishtë: (i) të nxisë miratimin e një qasjeje ndaj shqyrtimit të deklaratave financiare sipas SNRF-ve që bazohet më shumë te risku; dhe (ii) të shkëmbejë përvojën ndërkombëtare në shqyrtimin e informacionit financiar sipas SNRF-ve dhe përdorimin e Informacionit financiar të audituar sipas SNRF-ve në rregullimin prudencial. Prezantim i shkurtër njohës do të pasohet nga diskutimi në panel rreth *Shkëmbimit të Përvojës Ndërkombëtare*. Gjatë takimit, pjesëmarrësit do të ftohen t'u bëjnë pyetje prezantuesit dhe panelistëve.

Prezantues: **Michael Qell** | Konsulent, Banka Botërore

Panelistë:

Michael Wells | Konsulent, Banka Botërore

Derre Scott | Konsulent, Banka Botërore

David Grünberger | Shef sektori, Banka Qendrore Evropiane

Sonja Carshagen | Specialist i raportimit financiar, drejtorja e nxjerrjes së rregulloreve, Bursa e Johannesburgut (JSE)

Moderator: **Garik Sergeyan** | Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Banka Botërore

14:35 Pushim

15:00 Përditësim për SNRF-të dhe SNRF-të për NVM-të

Qëllimi i këtij sesioni është të diskutojë dhe përditësojë pjesëmarrësit lidhur me: (i) SNRF-të e fundit të reja dhe të ndryshuara; (ii) materiale të kohëve të fundit të Fondacionit për SNRF-të me synimin për të përmirësuar zbatimin e njëjtë të SNRF-ve; (iii) projekte të përzgjedhura të lidhura me SNRF-të dhe SNRF-të për NVM-të; dhe (iv) krijimin e Bordit Ndërkombëtar të Qëndrueshmërisë së Standardeve. Prezantimi do të pasohet nga një diskutim në panel. Gjatë takimit, pjesëmarrësit do të ftohen t'u bëjnë pyetje prezantuesit dhe panelistëve.

Prezantues: **Anne McGeachin** | Staf teknik, Fondacioni i SNRF-ve

Panelistë:

Michael Wells | Konsulent, Banka Botërore

Darrel Scott | Konsulent, Banka Botërore

Anne McGeachin | Staf teknik, Fondacioni i SNRF-ve

Bruce Mackenzie | Anëtar bordi, Fondacioni i SNRF-ve

Moderator: **Iwona Warzecha** | Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Banka Botërore

16:30 Fundi i Ditës së parë

AGJENDA | DITA 2 | E MARTË, 14 DHJETOR 2021 | 13:00 CET

13:00 Tema specifike për SNRF-të: interesat financiare

Qëllimi i këtij sesiioni është i dyfishtë: (i) në kuadër të pandemisë së Covidit, t'u rikthehet gjykimeve dhe çmuarjeve në matjen dhe raportimin e humbjeve të pritshme të kredive në përputhje me SNRF 9 dhe udhëzimeve rregullatore të lidhura me të për rregullatorët prudencialë; dhe (ii) të propozojë mbledhjen e mendimeve për shqyrtim nga BSNK-ja pas zbatimit të *Instrumenteve Financiare* të SNRF 9.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit do të ftohen t'u bëjnë pyetje prezantuesit dhe panelistëve.

Prezantues: **Darrel Scott** | Konsulent, Banka Botërore

Panelistë:

Darrel Scott | Konsulent, Banka Botërore

Cindy Siah Hooi Hoon | Drejtor i Departamentit të Politikave Financiare Prudenciale, Banka Negara, Malajzi

Bohdan Lukasevych | Shefi i Departamentit të Kontabilitetit, Krye kontabilist, Banka Kombëtare e Ukrainës

Liudmyla Snigurska | ZV/shef i Departamentit të Kontabilitetit – Shefi i Njësisë së Kontrollit, Taksave dhe Raportimit, Banka Kombëtare e Ukrainës

Moderator: **Andrei Busuioc** | Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Banka Botërore

14:30 Pushim

14:50 Tema specifike për SNRF-të: përgatitja për rregullimin e *Kontratave të Sigurimit sipas SNRF 17*

Qëllimi i këtij sesiioni është të diskutojë përgatitjet për rregullimin e zbatimit të SNRF 17 (dhe zbatimi i SNRF 9 nga siguruesit e kualifikuar). Sesiioni synon të rrisë të kuptuarit e gjykimeve kyç që duhet të japin drejtuesit për zbatimin e SNRF 17 dhe informacionin shpjegues që siguruesit duhet të paraqesin në pasqyrat vjetore financiare të shoqërive të tyre për 2021 lidhur me progresin e bërë në zbatimin e SNRF 17.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit do të ftohen t'u bëjnë pyetje prezantuesit dhe panelistëve.

Prezantues: **Darrel Scott** | Konsulent, Banka Botërore

Panelistë:

Darrel Scott | Konsulent, Banka Botërore

Michael Wells | Konsulent, Banka Botërore

Kosta Spaseski | Këshilltar i përgjithshëm për planifikim strategjik dhe menaxhim cilësie, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Maqedonia e Veriut

Nataliia Kolomiets | Shefe e Njesisë së Metodologjisë së Kontabilitetit, Departamenti i Kontabilitetit, Banka Kombëtare e Ukrainës

Kateryna Siukhina | Ekonomistja kryesore e Njesisë të Metodologjisë së Kontabilitetit, Departamenti i Kontabilitetit, Banka Kombëtare e Ukrainës

Moderator: **Jose Simon Rezk** | Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Banka Botërore

16:20 Fjala përmbyllëse

Jose Sifon Rezk | Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Banka Botërore

16:30 Fundi i Uebinarit

STAREP
bashkëfinancohet nga



 Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

REPARIS FOR SMEs
financohet nga



European Union

